



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2019:179525

Datë: 15.02.2024

Numri i dokumentit: 05331100

C.nr.36/24

Gjykata Themelore Pejë - Dega në Klinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Fllanza Hashani, në çështjen juridike kontestimore të paditësve A. F. H. , L. Xh. G. , nga fshati B... , Komuna Klinë, H. M. H. , me vendbanim në Rr. “...” nr. ..., K... , U. S. H. nga fshati B... , Komuna Klinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson C. G. , avokat nga K... , kundër të paditurit S. G. nga fshati B... , Komuna Klinë të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Z. M. avokat nga K... , me objekt kontesti vërtetim pronësie, jashtë seancës, me datë 12.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Procedura në këtë çështje juridike kontestimore NDËRPRITET për shkak të vdekjes së paditësit F. S. H. ish nga fshati B... , Komuna Klinë.

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdoj, kur trashëgimtarët e paditësit të marrin përsipër procedurën apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditësit, F. S. H. , U. H. , L. Xh. G. dhe H. M. H. pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi më datë 31.05.2011, kundër të paditurve, S. S. G. dhe A. B. S. , me objekt kontesti vërtetim pronësie në bazë të trashëgimisë, ndarjes fiziket të pronës së përbashkët familjare dhe mbajtjes me mirëbesim.

Gjykata E Apelit e Kosovës në Prishtinë, me Aktvendimin Ac.nr.5889/20 të dt.22.11.2023 ka prishur Aktgjykimin e Gjykatës Themelore Pejë-Dega në Klinë C.nr.353/2019 të dt.05.11.2020, dhe lëndën ka kthyer në rivendosje.

Sipas Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, gjykata në rivendosje është udhëzuar që fillimisht të ndërmar veprimet procedurale, ashtu që të ndërpres procedurën me Aktvendim të veçantë për shkak të vdekjes së paditësit F. S. H. , e që procedura rishtas të filloj pasi që trashëgimtarët e tij të marrin përsipër procedurën apo kur gjykata i thërrët ta bëjnë me propozim të palës kundërshtare, të sqarohet legjitimacioni aktiv i palëve dhe më pas të vërtëtohet gjendja faktike.

Nga certifikata e vdekjes me nr. Serik V10298969, me numër të referencës 8/2017RV/8010, numër rendor 9 e dt.21.10.2019, gjykata vërtetoi faktin se F. H. ka vdekur më 08.09.2017.

Duke qenë se lënda është kthyer në rivendosje, kjo gjykatë në bazë të rekomandimeve të Gjykatës së Apelit, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Me dispozitat e nenit 277, paragrafi 1, pika (a) të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore është përcaktuar se “procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim;”

Udhëzimi i Gjykatës për vazhdimin e procedurës në këtë çështje është bazuar konform nenit 280 par.1 të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË- DEGA NË KLINË

Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil

C.nr.36/24, të datës 12.02.2024

Gjyqtarja
Fllanza Hashani

KËSHILLË JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të tij, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.